



Prishtinë: 29.03.2018
Kodi i ZRRE-së: V_951_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1597_07_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **30.08.2017**.

në seancën e mbajtur më datë 29.03.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin H.M, nga Komuna e Prizrenit, me shifër të konsumatorit **DPZ - 16688** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1597_07_17 i datës 25.07.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 30.08.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se korrigjimi i faturës per periudhën nëntor 2015 nuk është i saktë pasi që kWh e faturuar paraqesin shpenzim real te konsumatorit. Përfaqësuesi i KESCO-s ka potencuar se faturimi i kWh te grumbulluar ne periudhën nëntor 2015 është si rezultat i mos qasjes ne piken e matjes per lexim te shpenzimeve nga periudha 08/09/10/2015. Në ankesë theksohet se qendra e kalibrimit po ashtu ka bërë shqyrtimin e saktësisë se matjes dhe se njehsori elektrik është brenda kufijve te lejuar te matjes. Po ashtu përmendet fakti qe Departamenti i faturimit ne KESCO ka bërë korrigjimin ne vlerë -15.36€ duke bere shpërndarjen e kWh te faturuar ne periudhën nëntor 2015 per periudhën dy mujore 10/11/2015 .

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e DMK/ZRRE _V_1597_07_17, në lidhje me shifrën DPZ - 16688 si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.



Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, se korigjimi i datës 01.12.2015 në vlerë -15.36€ është në përputhshmëri me dispozita ligjore të rregullave në fuqi, për Bordin pretendimet te tilla janë vlerësuar si të paqëndrueshme për faktin se nga analiza e bërë rrjedhës së energjisë elektrike konsumatori ka mos përputhje të shpenzimeve per periudha te njëjta me te hershme si dhe me te vonshme përkatësisht shpenzimi i faturuar ne periudhën nëntor 2015 nuk përputhët me shpenzimet reale te konsumatorit.

Bordi i ZRRE ka analizuar DMK ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të periudhës kontestuese 11/2015 prej 1184 kWh dhe shpenzimit të energjisë elektrike të periudhës së njëjtë para dhe pas kontestit dhe ka vërejtur se ka mos përputhje të shpenzimit të madhe. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike aktive vërehet se shpenzimi i faturuar në periudhën pas kontestit muaji 11/2016 është 70 kWh, ndërsa në periudhën para kontestit është: muaji 11/2014 është 124 kWh, periudha 11/2013 është 174 kWh, periudha është 345 kWh. Bazuar në analizën e shpenzimeve të konsumatorit për periudhën e njëjtë kohore, si dhe bazuar në leximet e rregullta mujore të shpenzimit të energjisë elektrike konstaton se shpenzimet e faturuara konsumatorit përmes faturës nr. 11150DPZ-16688 të datës 06.10.2012 nuk paraqesin shpenzim real te konsumatorit

Bordi ka analizuar edhe korigjimin e bërë nga Departamenti i Faturimit i KESCO-s përmes urdhër lejimit nr. 47559DPZ-16688-16688 me datë 01.12.2015 në vlerë prej -15.36€, ku është bërë shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 10/2015 – 11/2015, pasi që sipas KESCO-s në muajin 10/2015 ka bërë faturim të pa matur/paushall. Nga analiza e bërë shpërndarjes së shpenzimit të energjisë elektrike të bërë nga KESCO për periudhën 10/2015 dhe 11/2015 rezulton se mesatarja mujore e shpenzimit për këto dy muaj ka qenë 668.50 kWh/muaj, e që ky shpenzim nuk i përket shpenzimit mesatar mujor si para ashtu edhe pas periudhës kontestuese.

Bazuar edhe ne analizën e protokollit të shqyrtimit të njehsorit elektrik nr. 15353 e datës 25.09.2016 me te cilën është konstatuar se njehsori është brenda kufijve te lejuar matës por qe edhe bazuar ne analizën e rrjedhës së energjisë elektrike Bordi konstatoi se kilovatorët e faturuar konsumatorit në pikën matëse ka mundur të jenë si pasojë e ndonjë çrregullimi të mundshëm të pajisjes matëse për faktin se asnjë parametër nuk tregon se konsumatori ka mundur t'i shpenzoi një sasi të tillë të energjisë elektrike kur marrim për bazë shpenzimin para dhe pas periudhës kontestuese

Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore është konstatuar se në rastin konkret konsumatori ka obligim që të paguaj për atë që ka shpenzuar. Andaj edhe është kërkuar të shkarkohet konsumatori nga fatura e muajit 11/2015 në vlerë financiare prej 104.54€ për shkak të faturimit të pabazë dhe për këtë muaj KESCO duhet të ngarkoi konsumatorin me shpenzimet e energjisë elektrike si të muajit 11/2016 (TL=62 kWh dhe TU=8 kWh).

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.



- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit H.M dhe,
- Arkivit të ZRRE-së